



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.23/2011
Prishtinë, më 27.07.2011, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri dhe Biserka Kostić.

Munguan: Myzejene Selmani, Berat Buzhala dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Haxhi Gashi USAID/Deloitte, Besim Zeqiri ICO, Lejla Selimi OSCE , Shefki Kastrati NDI, Ukë Gashi ZPRK.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.07.2011;
3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente te Projektligjit nr.04/L-39 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit;
4. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr.03/-163 për Miniera dhe minerale;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - kërkoi që në rend dite të futen edhe dy pika si **pikë 5** e rendit të ditës: *Miratimi i rekomandimeve të dalura nga konferenca e organizuar nga Komisioni me datë 06.07.2011, dhe si pikë 6 e rendit të ditës: *Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për emërim të një antari të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.**

Rendi i ditës sëbashku me dy pikat e propozuara u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.07.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 22.07.2011 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente te Projektligjit nr.04/L-39 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Kryetari – I'a dha fjalën deputetit Hashim Deshishku, për të prezantuar në Komision propozim amendamentet në emër të Grupit punues për Projektligjin nr.04/L-39 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

Hashim Deshishku – theksoj se Grupi punues e ka shqyrtuar Projektligjin dhe I ka propozuar disa propozim-amendamente, te cilat janë si në vijim: **Amendamenti 1** Neni 3, pas nënparagrafit 1.26, shtohet një nënparagrafi I ri 1.27, si vijon: 1.27. RAPEX – nënkupton sistemin për shkëmbim të shpejte të informacionit në lidhje me masat dhe veprimet në veçanti për produktet të cilat paraqesin rrezik serioz për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorve; **Amendamenti 2** Neni 5 titullohet si vijon: “Detyrimet për nxjerrjen e akteve nënligjore”. Paragrafi 1, fjala ‘rregullore’ zëvendësohet me “akt nënligjor”; **Amendamenti 3** Neni 6, paragrafit 9, ndryshohen fjalitë e fundit si vijon: “gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës”; **Amendamenti 4** Neni 13 titullohet si vijon: “Deklarata e konformitetit”; **Amendamenti 5** Neni 14, titullohet si vijon: “Shenja e konformitetit”. Paragrafi 2, fjala “rregullore” zëvendësohet me “akt nënligjor”; **Amendamenti 6** Neni 16, titullohet si vijon: “Kërkesat minimale”; **Amendamenti 7** Neni 17 titullohet si vijon: “Autorizimi I trupave për vlerësim”; Paragrafi 6, fshihet teksti: “nuk lejohet ankese, por”; **Amendamenti 8** Neni 18 titullohet si vijon: “Zbatimi I detyrave ne procedurë të vlerësimit të konformitetit”; Nënparagrafi 2.2 fshihet. Nënparagrafi 2.3 riformulohet si vijon: 2.3 në mungesë të trupave të autorizuar për vlerësimin e konformitetit në Republikën e Kosovës vlerësimi i konformitetit kryhet nga trupat për vlerësim të konformitetit që janë të lajmëruara nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian në Komisionin Evropian, regjistri i të cilave është publikuar në “Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian”; **Amendamenti 9** Neni 20 titullohet si vijon: Shkëmbimi I informatave më vendet tjera”; **Amendamenti 10** Neni 22 titullohet si vijon: Paanshmëria e inspektorit”. **Amendamenti 11** Neni 23 titullohet si vijon: “Njoftimi per masat e ndërmarra”. Paragrafi 2, fshihet fjalia: “menjëherë”. Paragrafi 4, togfjalëshi “sa më shpejtë që është e mundur zëvendësohet me “sipas legjislacionit në fuqi”. **Amendamenti 12** Neni 24, titullohet si vijon: “Kompetencat e trupave inspektuese”. **Amendamenti 13** Neni 25, titullohet si vijon: “Njoftimi dhe informimi”; **Amendamenti 14** Neni 26, titullohet si vijon: “Sistemi për shkëmbim të shpejtë”; **Amendamenti 15** Neni 27, titullohet si vijon: “Sekreti I të dhënave”; **Amendamenti 16** Neni 32, titullohet si vijon: “Lejimi për qarkullim të lirë i produkteve”; **Amendamenti 17** Neni 33, titullohet si vijon: “Vendosja e vërejtjes”; **Amendamenti 18** Neni 35, titullohet si vijon: “Mangësitë formale”; **Amendamenti 19** Neni 35, ndryshohet titulli si vijon: “Nxjerrja e akteve nënligjore”. Paragrafi 1, afati “gjashtë (6) muajve” zëvendësohet me “dymbëdhjetë (12) muajve”. Paragrafi 2 dhe 3 fshihen. **Amendamenti 20** Neni 37 titullohet si vijon: “Dispozitat kalimtare”. Paragrafi 2 fshihet.

Lutfi Zharku – propozoj amendamentet si në vijim: **Neni 5**, paragrafi 7, fshihet teksti në vijim: “që ato të marrin pëlqimin nga Ministria përkatëse”; **Neni 8**, paragrafi 2 fshihet teksti si në vijim: “që prodhuesi e ka kryer një procedurë adekuate për vlerësim të konformitetit ”; **Neni 17** paragrafi 2, riformulohet teksti si në vijim: para fjalisë “konsiderohet” shtohet fjalitë “mund të” dhe pas fjalisë “dëshmi” shtohet fjalia “plotësuese”; **Neni 18** paragrafit 1, i shtohet teksti: “dhe organit kompetent inspektues”; **Neni 19**, paragrafi 2, pas fjalisë “kompetente” teksti ” do të njohin me kërkesë” zëvendësohet me “në pajtim me këtë ligj”; Prej **nenit 24** deri te neni 39, fjalitë “Trupi inspektues” zëvendësohet me “Organi inspektues”; **Neni 28**, paragrafi 4, fjalitë “Instituti profesional” zëvendësohen me “trupa për vlerësim të konformitetit”. Paragrafi 5, fjalitë “të nevojshëm” zëvendësohen me “siç parashikohet me akt nënligjor”. Paragrafi 7, fjalia “kompetent” fshihet, ndërsa fjalia “shtetit” zëvendësohet me “organet kompetente”; **Neni 29**, riformulohet si vijon: Shpenzimet e testimit, vlerësimit të konformitetit të produktit, mbulohen nga subjekti ekonomik i cili e ka vendos në treg ose në dispozicion të tregut produktin që nuk është konform kërkesave teknike; **Neni 34**, në tërë tekstin e Nenit fshihet fjalia “kundërvajtje”.

Komisioni u pajtua më propozimet e deputetit Zharku.

Visar Ymeri – propozoj që të fshihet amendamenti të nënparagrafët 2.2 dhe 2.3, në **nenin 18**, dhe të mbetën siç janë në Projektligj.

Komisioni u pajtua më propozimin e deputetit Ymeri.

Vërejtjet tek Amendamenti 7

Lutfi Zharku – apstenoj në votim dhe paraqiti vërejtje në lidhje me propozimin për ndryshimin e paragrafi 6, ku fshihet teksti: “nuk lejohet ankese, por”, tek Amendamenti 7.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohen Amendamentet për Projektligjin nr.04/L-39 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

4. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr.03/-163 për Miniera dhe minerale

Kryetari – fillimisht falënderoi Grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për minierat dhe mineralet, dhe të gjithë antarët tjerë që kanë marrë pjesë në aktivitete. Dhe në veçanti falënderojë raportuesen e Grupit punues zonjën Sala Berisha-Shala, për një agjendë mjaft dinamike për mbikëqyrje të zbatimit të këtij ligji. Ai shtoi se Raporti është mjaft i mirë dhe për më shumë rreth raportit fjalën i dha raportueses Sala Berisha – Shala.

Sala Berisha – Shala – falënderoi antarët e Grupit punues për angazhimin e tyre. Në vijim prezantoi raportin dhe tha se këtij raporti i është bashkangjitur dokumentacioni nga vizitat, dëgjimi publik, dhe aktivitete tjera. Ajo tha se Grupi punues ka konstatuar se në përgjithësi ligji është i zbatueshëm, por ka edhe pengesa serioze të natyrës teknike dhe pengesa tjera. Në bazë të atyre që kemi vërejt gjatë punës në terren dhe në takimet me Komunitatet dhe institucionet tjera i kemi nxjerrë këto rekomandime:

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik të hartojë dhe t’i dorëzojë Kuvendit të Kosovës Strategjinë minerare për shqyrtim dhe miratim në afatin prej tre (3) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve;
2. Ministria e Zhvillimit Ekonomik të themelojë Institutin Gjeologjik në afat prej gjashtë (6) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve;

3. Ministria e Zhvillimit ekonomik të themeloj Muzeun Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve në afat prej gjashtë (6) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve;
4. Ministria e Zhvillimit ekonomik të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore, siç detyron Ligji nr.03/L-163 për minierat dhe mineralet, në afatin prej tre (3) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve;
5. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, të nxjerr aktet e nevojshme nënligjore, siç detyron Ligji nr.03/L-163 për minierat dhe mineralet, në afatin prej tre (3) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve;
6. Qeveria e Republikës së Kosovës, të përfshijë në Strategjinë Legjislative të vitit 2011, Plotësim ndryshimin e Ligjit nr.03/L-163 për minierat dhe mineralet, në afatin prej tre (3) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve.

Pas leximit të rekomandimeve ajo poashtu falënderoi njësinë mbështetëse të Komisionit për mbështetjen e Grupit punues në të gjitha aktivitetet për mbikqyrjen e zbatimit të ligjit për minierat dhe mineralet dhe kërkoi nga antarët tjerë të Komisionit nëse kanë rekomandime tjera të propozojnë.

Kryetari – theksoi se KPMM gjatë raportimit kishte kërkuar mbështetje edhe nga mekanizma tjerë për largimin e operatorëve ilegal, për konfiskimin e mjeteve të tyre, dhe kërkoi të shtohet një rekomandim për kordinimin e institucioneve relevante për largimin e operatorëve ilegal.

Visar Ymeri – tha se prej vizitave që kemi pas në Drenas por edhe në Fushë Kosovë është vërejtur se sa i përket mbrojtjes së mjedisit ka shumë probleme në këtë fushë, dhe mendoj që një rekomandim është dashtë t'i shkojë drejtpërdrejt Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për me qenë më aktive në bashkëpunim me Kuvendet Komunale.

Hashim Dëshishku – theksoi se kur kemi qenë herën e fundit në KEK ka qenë një informatë prej antarëve të KEK-ut se në kohët e mëparshme 40% e rentës iu është dhënë Komunës, kurse tash komplet i shkon Qeverisë, dhe mendoj që Komunitat të cilat dëmtohen nga veprimtaritë minerare duhet të rekomandojmë që ato të përfitojnë një pjesë të rentës minerare. Poashtu deputeti Dëshishku tha se nga guroret e vizituara u njoftuam se kanë nevojë për furnizim më të shpeshtë me eksploziv, ndërsa Policia nuk ka staf të mjaftueshëm për përcjellje më të shpeshta.

Sala Berisha – Shala – shtoi se guroret paraqiten dy probleme distancat mes gurore të licencuara nga KPMM-ja, dhe problemi tjetër është se paraqitet rrezikshmëri për teknologjinë e njëra tjetrës, dha afërsia e tyre ndikon në zvoglimin e cilësisë së fraksioneve të materialeve sepse pluhuri i njëres gurore shkon te tjetra dhe ndikojnë në cilësinë e njëra tjetrës. Poashtu, shtoi se problem është transporti i eksplozivëve dhe është pengesë për guroret të cilat kanë nevojë për furnizim më të shpeshtë me eksploziv ndërsa mundësia e Policisë për përcjellje është e vogël. Në fund tha se është mirë të bëjmë një rekomandim lidhur me transportimin e mbetjeve të fenolit, sepse anëtarët e KEK-ut na njoftuan se transporti në kohë të nxehtë po krijon erë shumë të rëndë, dhe prej tyre është kërkuar që transporti të kryhet në kohë më të përshtatshme atmosferike.

Kryetari– kërkoi që Grupi punues së bashku me stafin mbështetës të përfshijnë në raport edhe këto rekomandime të cilat u bënë nga antarët e Komisionit.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr.03/-163 për Miniera dhe minerale.

5. Miratimi i rekomandimeve të dalura nga konferenca e organizuar nga Komisioni me datë 06.07.2011 me temën “Ndikimi i legjislacionit në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit”

Kryetari – theksoi se në konferencën e organizuar nga Komisioni me datë 6 korrik 2011, ka pas një angazhim të pjesëmarrësve si nga shoqëria civile ashtu edhe nga Ministrinë përkatëse, dhe janë nxjerrë disa rekomandime, të cilat i paraqiti para Komisionit, si në vijim: 1. Të intensifikohet bashkëpunimi i ndërsjellë Kuvend-Qeveri-Komuna-Shoqëri Civile dhe Asociacionet e Specializuara vendore dhe ndërkombëtare, në aspektin legjislativ; 2. Të përfshihet edhe Ministria e Arsimit në Komitetin për Zhvillim Ekonomik; 3. Draftimi i legjislacionit të siguroj që është në harmoni të plotë në konceptin e ekonomisë së lirë të tregut; 4. Ndryshimi dhe plotësimi i legjislacionit duhet të jetë çdo herë dhe në çdo kohë duke i'u përshtatur rrethanave të reja, ku ligjet duhet të hartohen në bazë të politikave; 5. Të nxirret Ligj i ri për Ndërmarrjet Publike; 6. Të modernizohet legjislacioni në aspektin e shpenzimeve buxhetore; 7. Amendamenti i Pakos së ligjeve për Bujqësinë; 8. Amendamenti i Pakos së ligjeve për skemën sociale; 9. Të shmangët kolizionin e ligjeve; 10. Të fuqizohet roli i bizneseve dhe asociacioneve të specializuara në draftimin e projektligjeve; 11. Ndryshimi dhe plotësimi i legjislacionit sekondar që mundëson krijimin e ambientit dhe kushteve të përshtatshme për të bërë biznes në këto fusha: Eliminimi i zvogëlimit të çmimeve të produkteve të gatshme, i cili po pamundëson kalkulimin real të produkteve të gatshme; Eliminimi i taksimit të dyfishtë siç është rasti në prodhimet agrare dhe përpunuesit e këtyre prodhimeve; Barazimi i prodhuesve kosovare me prodhuesit rajonal të CEFTA-s; Implementimi sa më i shpejt i arkave fiskale që të barazohen bizneset, sigurohen bizneset jashtë dhe të stabilizohet buxheti; Sektori i Bujqësisë dhe Industrinë e Tekstilit; 12. Të ndryshohet Strategjia e energjisë; 13. Të nxitët veprimtaria prodhuese dhe lehtësi doganore për lëndët e para dhe për material riprodhues; 14. Lista e pajisjeve të liruara nga ngarkesa doganore të zgjerohet dhe të jetë përputhje me prioritet zhvillimore dhe me interesat e biznesit; 15. Të futet në funksion krijimi i pushimeve të përkohshme tatimore, posaçërisht për ato biznese të cilat investojnë në prodhim dhe kanë shkallë të lartë të punësimit; 16. T'u ofrohet mundësia operatorëve privat apo biznesit shfrytëzimi i tokës publike me një kosto më të ulët, apo për një kohë të caktuar krejtësisht të lirohen nga pagesa e tatimit në pronë, apo e rentës; 17. Funksionalizimi i sistemit “One Stop Shops”, i cili aplikohet me qëllim që të lehtësohet kostoja dhe të shkurtohet koha për fillimin e një biznesi; 18. Ministrinë të raportojnë në Komisionin Parlamentar njëherë brenda vitit edhe pa kërkesë të Komisioneve, dhe të jenë aktive gjatë amendamentimit të projektligjeve në Komisionet Parlamentare;

Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohen Rekomandimet e dalura nga Konferenca e organizuar nga Komisioni me datë 06.07.2011.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për emërim të një antari të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Kryetari – njoftoi antarët e Komisionit për vendimin e Qeverisë për emërimin e antarit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, këtë dokument e kemi marr sot dhe ndoshta ka nevojë për më shumë kohë për ta shqyrtuar.

Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për emërimin e antarit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

7. Të ndryshme

a) Projektligjet e AKP-së

Kryetari– njoftoi se dje ka punuar Grupi punues për shqyrtimin e projektligjeve të pakos së AKP-së, dhe ka zvarritje aty pak. AKR ka thënë se do të sjellë disa propozime, ne kemi kryer punën tonë aty dhe kemi dhënë mundësi që ndërkohë të vijnë propozime me shkrim dhe në mbledhjen tjetër të Komisionit ne duhet me i shqyrtuar.

Visar Ymeri – theksoi se përveq propozimeve të AKR-së është mirë me krahasuar edhe me transkriptin e leximit të parë të këtyre projektligjeve sepse është debatuar edhe në Kuvend dhe ka pas edhe vërejtje të deputetëve.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Në mbledhjen e radhës të shqyrtohen propozim-amendamentet për pakon e Projektligjeve të AKP-së.

b) Çështjet vijuese

Visar Ymeri - kërkoi që në Komision të kemi një ekspert të fushës ekonomike, dhe poashtu ai tha se gjat takimit me Kryetarin e Autoritetit të Konkurrencës, është pyetur se qka ndodh tash me raportin i cili nuk është miratuar në Kuvend, a duhet me kthi perseri raportin, apo çka duhet bërë.

Kryetari – lidhur me angazhimin e ekspertit ekonomik, ai tha se ne kemi disa emra por mund të propozoni edhe të tjerë dhe mund të angazhojmë një ekspert ekonomik. Sa i përket raportit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ai tha se kam pas dje takim me Kryetarin e Kuvendit, dhe do të kërkoj sqarime nga zyra ligjore e Kuvendit lidhur me këtë çështje.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

1. Do të miratohet lista e ekspertëve për Komisionin.
2. Çështja e Raportit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, do të sqarohet sipas ligjit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

Përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit